

Rekomandimet e OSBE/ODHIR: Zgjedhjet vendore 2023

Rekomandime te tjera

Nr	Rekomandimi OSBE/ODIHR	Statusi implementimit	Komente dhe shënime të tjera
18	Duhet të hiqen kufizimet e të drejtës së kandidimit të personave, fajësia e të cilëve për kryerjen e një vepre penale nuk është provuar me vendim gjyqësor të formës së prerë. Duhet t'i kushtohet vëmendje rishikimit të pragut për mbështetjen e zgjedhësve për të garantuar të njëjtat kushte të zbatueshme për kandidatët e pavarur dhe atyre të propozuar nga partitë.	Progres i Moderuar	Nuk ka kufizim për të drejtën e kandidimit për personat fajësia e të cilëve nuk është provuar me një vendim të formës së prerë. Duhet të ulet numri i mbështetësve prej max 3000 zgjedhës për kandidatin e pavarur në zonën zgjedhore përkatëse. Ndërkohë për kandidatët e listës së subjekteve zgjedhor parti politike kërkohet që kjo listë të ketë jo më pak se 5000 zgjedhës në shkallë kombëtare dhe për koalicionet jo më pak se 7000 zgjedhës në shkallë kombëtare. Kodi aktual nuk parashikon kushte propocionale për kandidatët e pavarur dhe kandidatët e propozuar nga partitë politike.